



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

Ë-buletin

Prill, 2015

Veprimi sindikal dhe efekte pozitive

Përshkrim i aktiviteteve deri te mbarimi i veprimit sindikal



Gjatë këtij muaji Këshilli Drejtues i SBASHK-ut realizoi shumë takime sa i përket çështjes së mos realizimit të pikave të Kontratës Kolektive, të nënshkruar vitin e kaluar, në mes të MASHT dhe SBASHK. Edhe pas tri veprimeve të përshkallëzuara sindikale që SBASHK-u pati në fillim të këtij viti, Qeveria nuk realizoi deri tani atë që e ka deklaruar vet lidhur me 0.5 % të përvojës së punës për çdo vit shërbimi... (faqe 4)

Takime të shumta me institucionet e Kosovës
SBASHK-u shembulli më i mirë i një sindikate të vërtetë

Nga muaji janar SBASHK-u u përball me sfidën për implementimin e Kontratës Kolektive ... (faqe 11)

Disa nga aktivitetet sindikale në komuna

Sindikatat komunale gjatë këtij muaji

Në këtë numër të gazetës elektronike "Arsimimi Sot", po paraqesim disa nga aktivitetet ... (faqe 12)

Intervistë me znj. Nedime Ujkani, anëtare në SBASHK
Hetohet fuqizim i rolit të femrës në shoqërinë tonë

Nedimja me përvojën e saj si mësimdhënëse, por edhe si menaxhere ... (faqe 3)

Leter mbështetjeje nga ETUCE

Grevë e përgjithshme në sektorin e arsimit të Kosovës



Education International
Internationale de l'Education
Internacional de la Educación



Sindikata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK), organizatë anëtare e ETUCE në Kosovë, ... (faqe 8)

SBASHK-u vitizoi sindikatën e Arsimit të Holandës
Bordi Kombëtar i AOB-së u njoftua me aktualitetin në SBASHK



Një delegacion i SBASHK-ut, i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj, menaxheri financiar Ymer Ymeri dhe asistente Vlora Rexhepi Berisha, ... (faqe 11)

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Editorial

SBASHK-u krenohet me unitetin që ka



Kush më mirë nuk e dëshmon unitetin dhe forcën e një sindikate se sfidat dhe veprimet sindikale në mbrojtje të kërkesave legjitime. Kjo u dëshmuar gjatë gjithë kësaj kohe në SBASHK. Të punësuarit në arsimin e Kosovës kryenin me përkushtim detyrat në misionin e tyre të shenjtë për arsimimin e brezave, por qëndronin në gatishmëri për të vepruar me veprime sindikale kur duhej për të mbrojtur kërkesat e tyre. Treguan një unitet të shkëlqyer të punësuarit në arsimin e Kosovës dhe për këtë flasin shifrat e faktet. Mbi 99 % e punëtorëve arsimor iu përgjigjen vendimit të Këshillit Drejtues për veprime sindikale. Unitet i shkëlqyer në Arsimin Parauniversitar dhe në Universitet. Kjo forcë pozitive dhe ky unitet pas përballjes me shumë sfida e strese rezultoi me sukses. Qeveria nisi ta

implementojë Kontratën Kolektive dhe ky është lajm i mirë dhe është arritje e SBASHK-ut. Kontrata u nis të implementohet dhe populli e thotë bukur se ajo që niset edhe kryhet. SBASHK-u do të vazhdojë me angazhimet edhe për pikat tjera të Kontratës dhe pret mirëkuptimin dhe angazhimin e MASHT-it dhe të institucioneve lokale të qeverisjes. Kur të gjithë kryejnë pjesën e tyre të obligimit punët kryhen mirë.

Tani na presin shumë punë e angazhime sindikale. Do të organizohen takime me përfaqësues shoqatash sindikale e me kryetar nivelesh dhe do të debatohen hapur gjithë çështjet. Do të dalin ide e obligime të reja dhe do të vazhdojmë me arritjet sepse kemi besim të njëri-tjetri sepse kemi unitetin e shkëlqyer që është forca jonë e madhe e që duhet ta ruajmë bashkërisht pa i lënë hapësirë ndonjë individi që nuk e do SBASHK-un të tentojë të dëmtojë këtë unitet. SBASHK-u krenohet me unitetin që ka.

SBASHK-u do të vazhdojë me dialogun me Qeverinë dhe me pushtetin lokal në shërbim të arsimit të Kosovës dhe anëtarësisë sonë. Radhën në SBASHK po shtohen çdo ditë dhe kjo shton edhe obligimet tona të përbashkëta. Të vazhdojmë me angazhimet dhe arritjet e reja sepse ky është misioni ynë sindikal.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Në kuadër të projektit të përbashkët SBASHK-KEC "Fuqizimi i rolit të SBASHK-ut në hartimin e politikave arsimore", SBASHK-u së shpejti do të ofroj shërbime juridike për anëtarët e vet.

SBASHK-u ka filluar të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet nëpër tërë komunat e Kosovës

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 19.000 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Implemented by:




Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë

Hetohet fuqizim i rolit të femrës në shoqërinë tonë



Nedimja me përvojën e saj si mësimdhënëse, por edhe si menaxhere e shkollës është tani e sa vite anëtare e SBASHK-ut. Ajo përcjellë mendimet dhe përvojën e saj edhe për rolin e femrës në arsim, sindikatë por edhe në shoqërinë kosovare.

Nedimja vlerëson punën e SBASHK-ut dhe mendon se duhet bërë edhe më, që femra të jetë në të gjitha organet sindikale për ta dhënë kontributin e saj.

Arsimimi Sot :

1.Kush është Nedime Ujkani?

Ujkani:

Jam Nedime Ujkani ,profesoreshë e gjuhës dhe letërsisë shqipe në gjimnazin „Eqrem Çabej” në Vushtrri. Kam punuar si arsimtare nga viti 1992 ,për dy vjet me radhë kam qenë drejtoreshë në shkollën e mesme të ultë në Reznik ,ndërsa nga 2010 jam pjesë e këtij gjimnazi. Që nga dita e parë e punës në institucionet arsimore, kam qenë anëtare e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit të Kosovës (SBASHK).

Arsimimi Sot:

2.Sa është e përfaqësuar femra në procesin edukativo-arsimor në komunën tuaj?

Ujkani:

Në procesin e edukimit e të arsimit besoj se femrës i është dhënë një përkrahje e merituar,mirëpo në pozitat udhëheqëse mund të përfshihet më tepër.

Arsimimi Sot:

3. Cili është roli i femrës në angazhimin sindikal në komunën tuaj?

Ujkani:

Sa i përket angazhimit sindikal femra është lënë bukur shumë anash .Sa unë kam njohuri pak ka femra të angazhuara në këtë drejtim.

Arsimimi Sot:

4. Çfarë e shtyri shkollën tuaj të anëtarësohet në SBASHK?

Ujkani:

Deri para pak kohe në shkollën tonë kemi qenë vetëm dy apo tre anëtarë të kësaj sindikate,madje edhe ne kemi ardhur si anëtarë nga shkollat tjera. Besoj që me veprimet e fundit të krerëve të SBASHK-ut ,ka filluar të kthehet besimi .

Arsimimi Sot:

5. Çfarë i propozoni SBASHK-ut të bëjë më shumë në shërbim të anëtarësisë?

Ujkani:

Mendoj që përfshirja e femrës të jetë më e madhe,gjithashtu SBASHK-u duhet të angazhohet akoma më shumë në mbrojtjen e anëtarëve të saj.

Arsimimi Sot:

6. Cilat trajnime do t'ia propozoni SBASHK-ut për anëtarësinë e vet?

Ujkani:

Do të ishte mirë që brenda një shkolle të kenë trajnime të barabarta apo edhe të përafërta mësimdhënësit ,e jo disa kualifikohen e ngriten profesionalisht ,kurse disa mbesin në saje të mospërfshirjes me arsyetimin se nuk ka më projekte të tilla,apo nuk ka mjete për to. Këto mangësi do ishte mirë të mos ishin,andaj ftoj SBASHK-un do të angazhohet që kjo të mos ngjaj.

Arsimimi Sot:

7. Çfarë do të veçonit për të mirë në SBASHK?

Ujkani:

Fillimi i një komunikimi ndryshe me institucionet arsimore respektivisht rikthimi i besimit!

Arsimimi Sot:

8. Për fund?

Ujkani:

Faleminderit!

Veprimi sindikal dhe efekte pozitive

Përshkrim i aktiviteteve deri te mbarimi i veprimit sindikal



Gjatë këtij muaji Këshilli Drejtues i SBASHK-ut realizoi shumë takime sa i përket

çështjes së mos realizimit të 0.5 % të përvojës së punës për çdo vit shërbimi ashtu sic është e cekur në Kontratën Kolektive, të nënshkruar vitin e kaluar, në mes të MASHT dhe SBASHK. Edhe pas tri veprimeve të përshkallëzuara sindikale që SBASHK-u pati në fillim të këtij viti, Qeveria nuk realizoi deri tani atë që e ka deklaruar vet lidhur me 0.5 % të përvojës së punës për çdo vit shërbimi. Kjo sjellje e Qeverisë nuk i la rrugë tjetër SBASHK-ut veçse të marr veprime të lejuara sindikale, pra që të shpall grevë të përgjithshme në afat të pacaktuar, gjegjësisht deri sa Qeveria të reflektojë pozitivisht. Kështu Këshilli Drejtues në takimin e datës 2 prill mori vendim që greva e përgjithshme të filloj me 20 prill 2015 dhe jo me 13 prill ashtu siç ishte paraparë për shkak se me data 15,16 dhe 17 prill 2015 do të mbahet testi ndërkombëtar i vlerësimit të njohurive të nxënësve të moshës 15 vjeçare - PISA 2015. Për këtë çështje ishte njoftuar përmes një letre edhe ministri i arsimit, z.Arsim Bajrami, i cili është informuar për datën e hyrjes në grevë e cila do të vazhdojë deri në afat të pacaktuar, apo deri në plotësimin e kërkesave të SBASHK-ut. “Në këtë kërkesë e kemi njoftuar ministrin Bajrami edhe për vendimin e Këshillit Drejtues i cili është bazuar në kërkesën e mësimdhënësve të Kosovës të cilët kanë kërkuar se kësaj radhe ditët e humbura në grevë nuk do të kompensohen, dhe Këshilli e ka pranuar këtë dhe në këtë grevë nuk do të përfshihen edhe çerdhet, për të cilat sindikata ka thënë se do t’u shkaktonin problem prindërve që punojnë në pamundësi për t’u kujdesur për fëmijët”, tregoi kryetari i SBASHK-ut, z.Rahman Jasharaj. Qeveria e Kosovës kësaj radhe pa se mësimdhënësit janë shumë të indinjuar më këtë situatë dhe se janë këmbëngulës në arritjen e

kërkesave të tyre. Ajo mbajti mbledhje të jashtëzakonshme me datë 17 prill, ku nga ajo mbledhje nuk doli asgjë konkrete lidhur çështjen e implementimit të 0.5 % për çdo vit shërbimi për të punësuarit në arsimin e Kosovës. SBASHK-u analizoi tekstin e dalë nga mbledhja e Qeverisë së Kosovës dhe vlerësoi se në atë tekst, që quhet Propozim-vendim, nuk kishte asgjë konkrete sepse nuk ishte thënë asgjë me afat lidhur me implementimin e kërkesave të SBASHK-ut, që tani më ishin të njohura për gjithë opinionin në Kosovë dhe shuma që ishte përmendur në atë mbledhje të Qeverisë nuk ishte përputhur me kërkesat reale që ishin. Kështu kryesia autorizoi kryetarët e niveleve komunale të SBASHK-ut dhe atë të SUSHK-ut që të debatojnë me anëtarësinë dhe me datë 19 prill ta konfirmojnë edhe një herë mendimin e mësimdhënësve në takimin e jashtëzakonshëm



të Këshillit Drejtues.

Më datë 19 prill para takimit të jashtëzakonshëm të Këshillit Drejtues, u realizua një takim i shkurtër me ministrin e MASHT-it, z.Arsim Bajrami me bashkëpunëtorë. Në këtë takim ministri Bajrami, njoftoi përfaqësuesit e SBASHK-ut edhe njëherë që është marr vendimi nga Qeveria e Kosovës dhe ky vendim do të hyj në fuqi me pagat e prillit 2015, në të cilin takim ministri Bajrami kërkoi mirëkuptim nga udhëheqësit e SBASHK-ut që të prolongohet greva dhe gjatë javës do të shihen rezultatet se listat e pagave do të fillojnë të punohen me ndryshimet sipas kërkesës së SBASHK-ut. Po në këtë ditë u mbajt mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut ku kryetari i SBASHK-ut Rahman

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Jasharaj i njoftoi të pranishmit për të gjitha takimet dhe aktivitetet që janë bërë nga mbledhja e kaluar e Këshillit Drejtues dhe duke përfshirë edhe takimin e ditës së sotme me ministrin Bajrami. Një pjesë e përfaqësuesve të mësimdhënësve sindikalistë nga Komuniteti i Kosovës ishin të zëshëm në kërkesën që greva të nis më 20 prill, ashtu si ishte vendosur në takimin e Këshillit Drejtues më 2 prill, por shumica e kryetarëve të Kuvendeve të Sindikatave të Arsimit Parauniversitar dhe Arsimit Universitar vendosi që të jepet edhe një javë afat Qeverisë për të implementuar vendimin që e ka marrë me datën 17.04.2015 që me pagat e prillit 2015 të futet në mënyrë retroaktive përvoja e punës 0.5% të pagës bazë për çdo vit të përvojës së punës.



Pas një debati të gjatë Këshilli Drejtues i SBASHK-ut me shumicë votash mori vendim që

të pritët Qeveria deri më datën 24 prill 2015 nëse do ta respektojë ajo vendimin e vetë nga Mbledhja e jashtëzakonshme lidhur me implementimin e 0.5 % të përvojës së punës për çdo vit shërbimi.

Ky veprim i Këshillit Drejtues dëshmoi edhe një herë se SBASHK-u ishte dhe mbetet i përkushtuar për dialog korrekt dhe pret që Qeveria, më në fund të dëshmohet me vënien në jetë të vendimit të saj.

Edhe pas këtij veprimi të SBASHK-ut që të shtyjë grevën e përgjithshme, Qeveria edhe një herë dëshmoi se nuk merret me realizmin e atyre që thotë dhe vendos, por me tentativë për mashtrim. Pikërisht të premten, më 24 prill, kur ishte arritur marrëveshja që përvoja e punës për të punësuarit në arsim të fillojë se paguari me pagat e muajit prill dhe kur ishin bërë të gjitha kalkulimet buxhetore për të realizuar këtë nga një takim në mees të ministrit Bajrami, Hoti dhe jagcilar, në të cilin takim ishte edhe përfaqësuesi i SBASHK-ut dhe ishte arritur marrëveshja që listat e pagave për të punësuarit në arsim për muajin prill mund të vonohen por dot dalin me ndryshimet e parapara. Në orët e pasdites po të

njëjtën ditë u publikuan listat e pagave me disa ndryshime simbolike duke përfshirë vetëm rreth 18.883 të punësuar, nga rreth 29.000 sa janë të punësuar në arsim. Ndërsa llogaritja në këto lista nga ana e Qeverisë ishte bërë duke e imagjinuar një pagë bazë për arsimin fillor 216 euro, ndërsa për arsimin e mesëm 236 euro dhe duke i lënë jashtë kësaj llogarie rreth 10.000 të punësuar në arsim dhe duke mos përfshirë vitet e përvojës së punës nga viti 2008 deri në 2015. Ndërsa është dashur që llogaritja të bëhet ashtu sic e parasheh Kontrata Kolektive dhe vendimi i Qeverisë se pagesa për çdo vit shërbimi është 0.5 % e pagës bazë, që në arsimin fillor është 405 euro, ndërsa në atë të mesëm është 442 euro.

SBASHK-u me të marrë lajmin për këtë veprim ka kontaktuar Ministrin e MASHT-it për të kërkuar sqarim nga i cili nuk ka marrë përgjigje pse ka ndodhur kjo me arsyetimin se është vikend dhe nuk mund të thuhet diçka rreth kësaj. Po ashtu me 27 prill iu kemi drejtuar Ministrave Bajrami, Hoti dhe Jagcilar me kërkesë që të tërhiqen listat e pagave të lëshuara jo konform Kontratës Kolektive dhe marrëveshjes dhe që janë të pambeshtetura në asnjë akt e dokument zyrtar dhe kemi kërkuar që ato të përmirësohen, prandaj SBASHK-u ka ftuar takimin e jashtëzakonshëm të Këshillit Drejtues po këtë ditë (e hënë, 27 prill) për të analizuar situatën.

Në këtë takim të Këshillit Drejtues i cili u mbajt në orët e pasdites, pas raportimit të kryetarit për situatën e krijuar, ashtu sic e cekëm më lartë dhe një diskutimi nga të gjithë përfaqësuesit e të gjithë sindikalatave të komunabv, erdhi konkludimi se qeveria me një veprim të tillë, tentoi edhe njëherë ti mashtroi mësimdhënësit, për shkak se nuk bëri asnjë ndryshim ashtu sic kërkoj në listat e pagave të muajit prill dhe unanimisht vendosen që greva e përgjithshme sindikale në Arsimin Parauniversitar dhe në atë Universitar të Kosovës të fillojë me datë 29 prill, dhe të zgjas për aq kohë sa Qeveria nuk i përmirëson gabimet e lëshuara në listat e pagave për muajin prill siç ishin: nuk është marrë parasysh baza e pagës aktuale, nuk janë përfshirë të gjithë të punësuarit në arsim në pagesën e përvojës së punës si dhe nuk është llogaritur përvoja e punës nga viti 2008 e deri në vitin 2015.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC





E veçantë e kësaj greve të përgjithshme ishte se universiteti ka kërkesa të veqnata krahasuar me arsimin parauniversitar, për shkak se up kërkon nënshkrimin e kk të Universitetit me këshillin drejtues të këtij institucioni të lartë.

Kësaj greve iu përgjigjën rreth 99 % të institucioneve arsimore në nivel vendi, nga 1153 institucione sa janë gjithsejtë, vetëm 17 nga to kanë punuar, ndërsa sa i përket fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, nga 17 fakultete sa janë gjithsej 14 nga to, duke përfshirë këtu edhe fakultetin në Mitrovicë i janë përgjigjur grevës së përgjithshme. Këshilli Qendror Grevist gjatë grevës vizitoi shumë shkolla dhe bashkëbisedoi me grevistët, ku të gjithë mbronin qëndrimin se greva do të vazhdojë deri sa të dalin pagat për muajin prill dhe të shihet nëse Qeveria vërtetë ka



respektuar njërën pikë të Kontratës Kolektive e që ka të bëjë më 0.5 % të përvojës së punës për çdo vit shërbimi për pagën bazë aktuale për të gjithë të punësuarit në arsim.

Gjatë ditës së parë të grevës morëm informacione se kishin filluar të shpërndahen lista të reja nëpër disa institucione arsimore, por edhe në ato lista kishte gabime në llogaritjen e përvojës së punës të mbi 90% e të punësuarve, të cilëve iu mungonin 7 vite të përvojës së punës si dhe nuk ishte bërë ndryshimi i pagesës për muajt Janar, Shkurt dhe Mars të vitit 2015 ashtu siç shkruan në Kontratën Kolektive dhe siç ishin

deklaruar çdo herë edhe Kryeministri Mustafa edhe Ministrat Bajrami e Hoti.

Dhe kështu Këshilli Qendror Grevist i përkrahur nga të gjitha Këshillat greviste Komunale dhe nga Këshilli grevist i Universitetit i njoftoi të gjithë punonjësit arsimor se greva e përgjithshme do të vazhdojë , çdoherë duke kërkuar nga Qeveria që në afat optimal ti përmbushin edhe këto lëshime që i kanë bërë në mënyrë që mos të humbet mësimi.



Në ditën e dytë të grevës së përgjithshme, morëm informacione se janë procesuar pagat dhe se janë bërë ndryshime në gabimet e lëshuara më parë, por edhe në këto lista ka mjaftë gabime. Kështu Këshilli Qendror Grevist i SBASHK-ut realizoi takime edhe përkundër ditëve të pushimit me Këshillat Greviste komunale, në mënyrë që të bëjnë llogaritjet dhe evidentoj se në listat e pagave ka gabime në llogaritjen e viteve të përvojës në shumicën e të punësuarve në arsimin parauniversitar. Gjatë gjithë këtyre ditëve asnjëherë nuk pati takime mes Këshillit Qendror Grevist dhe MASHT-it, e cila bllokadë e komunikimit u thya pikërisht ditën kur ishte caktuar të mbahet Mbledhja e jashtëzakonshme e KD të SBASHK-ut dhe pikërisht atë ditë (e diel 3 Maj) kryetari i SBASHK-ut Rahman Jashari i shoqëruar nga Menaxheri i Financave Ymer Ymeri u takua me Ministrin e MASHT-it Prof.Dr. Arsim Bajramin dhe kabinetin e tij dhe pas një bisede të gjatë e konstruktive shprehen qëndrimet e të dy palëve të cilat qëndrime Kryetari i SBASHK-ut ,po këtë ditë (3 maj) i paraqiti në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kryesisë dhe duke analizuar të dhënat e arritura nga kryetarët e sindikatave komunale përmes bisedave telefonike gjatë gjithë vikendit. Po këtë ditë u mbajt mbledhja e

Implemented by:



jashtëzakonshme e Këshillit Drejtues ku kryetari Rrahman Jasharaj njoftoi të pranishmit rreth raportimeve të arritura nga komunat.

Nga këto raportime u konkludua se në listat e pagave të muajit prill ka mjaft gabime në llogaritjen e viteve të përvojës së punës, por gjithashtu u konkludua se përvoja e punës është paguar më 0.5 % në pagat bazë aktuale për çka e konsiderojmë si një arritje e SBASHK-ut . Kjo ngase nga 18.886 të punësuarve sa u paguhej përvoja dikur e deri në muajin mars 2015 , tani u paguhet rreth 29.000 të punësuarve në arsim. Po ashtu të pranishmit kryetari Jasharaj i ka njoftuar për takimin mes SBASHK-ut e Ministrit Bajramit dhe kabinetit të tij. Në këtë takim pas një diskutimi korrekt palët kanë ardhur në përfundim se duhet vazhduar me dialogun në shërbim të arsimit, jo vetëm për pagat dhe zbatimin e



Kontratës Kolektive por edhe për të gjitha çështjet në interes të arsimit në përgjithësi. Ata janë dakorduar se bashkëpunimi do të jetë korrekt nga të dy palët.

Pas kësaj u zhvillua një debat dhe u ngriten vërejtje ku pjesa më e madhe e kryetarëve kanë paraqitur qëndrimet e anëtarësisë nga komunat e tyre dhe ishin të mendimit se greva duhet të pezullohet , gjë që nënkupton se mësimi të rifillon të hënën, më 4 maj.

SBASHK, MASHT dhe MF u dakorduan që të ngritin një komision të përbashkët që do të angazhohet për evitimin e gabimeve që janë

paraqitur në listat e pagave të muajit prill. Kishte aty e këtu edhe diskutime kundër ndërprerjes së grevës, por pas hedhjes në votim me një votë kundër dhe dy abstenime u vendos që të hënën , më 4 maj, të rifillojë procesi arsimor në gjithë Arsimin Parauniversitar.

Përfaqësuesi i SUSHK-ut, Bardh Bardhi, u deklarua se me 4 maj Kuvendi i Sindikatës së Universitetit do të mbaj takim të jashtëzakonshëm dhe do të vendos për hapat e ardhshëm të veprimeve sindikale në Universitet, që do të thotë se SUSHK do të vazhdoj me grevë deri në një vendim tjetër të Kuvendit të SUSHK-ut për arsye se kërkesat e grevistëve Universitar nuk janë



përmbushur pasi që nuk ka sinjale të nënshkrimit të Kontratës Kolektive nga ana e Këshillit Drejtues të Universitetit.

Përfundimi i kësaj greve rezultoi me sukses duke fituar të punësuarit në arsim përvojën e punës 0.5% në pagën bazë aktuale dhe qëndrimet e përbashkëta të SBASHK-ut, MASHT-it dhe MF-së që gabimet në vitet e përvojës së punës të përmirësohen me listat e pagave të muajit maj. Meritë e të gjitha këtyre arritjeve janë anëtarësia e SBASHK-ut, e cila tregoi një unitet të madh gjatë grevës dhe tregoi që ka besim në organet udhëheqëse të SBASHK-ut, e cila cdoherë kur iu bë thirrje për veprim sindikal apo ndërprerjen e veprimit sindikal ishte unike. Gjithashtu duhet t'i falënderojmë shumë edhe ata punëtorë të arsimit, të cilët nuk janë anëtarë të SBASHK-ut, por pa asnjë hezitim përkrahën veprimet sindikale të shpallura nga Këshilli Drejtues i SBASHK-ut.

Një përkrahje të madhe për këto veprime morëm edhe nga Internacionalja Botërore e Arsimit (EI) , Komiteti Evropian i Sindikatave të Arsimit (ETUCE), sindikata e Arsimit të Holandës (AOB), Federata e Sindikatave të Arsimit Amerikan (AFT), Sindikata e Arsimit e Sllovenisë (SVIZ), Sindikatat e Arsimit të Shqipërisë, Maqedonisë etj.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Shkrimet për veprimin sindikal të SBASHK-ut nga EI dhe ETUCE

Komiteti i Sindikatave Evropiane për Arsimin (ETUCE)

Grevë e përgjithshme në sektorin e arsimit të Kosovës

Publikuar: 29 prill 2015

Sindikata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK), organizatë anëtare e ETUCE në Kosovë, organizon një grevë të përgjithshme në arsimin para-universitar dhe universitar, sot, më 29 prill 2015. Ky është një akt kundër taktikave të patolerueshme vonës së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës (MASHT) në drejtim të përfundimit të zbatimit të Kontratës Kolektive e cila është nënshkruar tashmë një vit më parë. Marrëveshja merret me çështjet që kanë të bëjnë me kompensimin e përvojës të punës së mësimdhënësve, të daljes në pension, kostot e transportit dhe ushqimin.

SBASHK kishte organizuar tre veprime paralajmëruese në fillim të vitit të cilat kishin mbetur pa një ndikim të qëndrueshëm. Qeveria filloi të reagojë vetëm javën e kaluar, pas vendimit të Këshillit Drejtues të sindikatës për një

Më poshtë mund të gjeni letrën origjinale në gjuhën angleze:

grevë dhe njoftoi për të marrë parasysh menjëherë përshtatjen e pagave në bazë të përvojave të punës siç janë rënë dakord. Megjithatë, sipas Rrahman Jasharaj, Kryetar i SBASHK-ut, kjo nuk ndodhi. Situata përkeqësohej. Në shumë shkolla, pagat janë paguar në bazë të një niveli të pagës të para dhjetë viteve, pa marrë parasysh disa vite përvojë pune. Sipas Jasharaj, greva do të zgjasë derisa Qeveria korrigjon gabimet në listën e pagave, duke përfshirë obligimet e tjera të Qeverisë që dalin nga Kontrata e nënshkruar në mes të SBASHK dhe MASHT.

ETUCE ka adresuar një letër në solidaritet me SBASHK-un duke deklaruar se ajo qëndron pa rezerva me njerëzit protestues dhe mbështet kërkesat e tyre të drejta dhe të justifikuara për një korrigjim të menjëhershëm të qasjes së pasaktë dhe të padrejtë të Ministrisë.

<http://www.csee-etuice.org/news/archive/887-general-strike-in-the-education-sector-of-kosovo>



The screenshot shows the ETUCE website with a news article titled "General strike in the education sector of Kosovo" published on 29 April 2015. The article text states: "The Union of Education, Science and Culture of Kosovo (SBASHK), member organisation of ETUCE in Kosovo, is organising a general strike in the pre-universities and universities, today, on 29 April 2015. This is an act against the intolerable delaying tactics of the Ministry of Education, Science and Technology of Kosovo (MEST) towards completing the implementation of the collective agreement which was signed already a year ago. The agreement deals with issues related to the compensation of teachers' work experience, retirement, transportation costs and meals." It also mentions that SBASHK had organized three warning actions at the beginning of the year which had remained without a lasting impact. The government started to react only last week after the union's executive council's decision for a strike and announced to take immediate account of the salary adaptation based on work experiences as agreed. However, according to Rrahman Jasharaj, the President of SBASHK, this did not happen. The situation was even worsening. In many schools, salaries were paid based on a ten years outdated salary level, disregarding several years of work experience. According to Jasharaj, the strike is to last until the government corrects the errors in payroll, including the other government obligations arising from the agreement signed between SBASHK and MEST. ETUCE addressed a letter in solidarity to SBASHK stating that it stands unreservedly with the protesting people and supports their fair and justified demands for an immediate correction of the Ministry's inaccurate and unfair approach.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Edukimi Internacional (EI)

Kosovë: Përpjekjet sindikale për Kontratën Kolektive përkrahur nga mbështetja e gjerë Evropiane (4 maj 2015)

Rajoni Evropian i Edukimit Internacional (EI) është duke kërkuar që autoritetet publike të Kosovës të zbatojnë plotësisht Kontratën Kolektive që u nënshkrua një vit më parë.

Më 29 prill, Komiteti i Sindikatave Evropiane për Arsimin (ETUCE) i shkroi degës së Edukimit Internacional (EI): Sindikata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK), duke shprehur solidaritetin e vet me sindikatën për veprimet sindikale që këtë mëngjes i filloi në arsimin para-universitar dhe universitar.

Letra vuri në dukje "taktikat e patolerueshme të shtyrjes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës (MASHT)" në mos respektimin e Kontratës Kolektive të nënshkruar me përfaqësuesit e sindikatës, duke pranuar se "durimi tyre ka qenë me të vërtetë i vënë në provë".

Ende në pritje

Sindikata i kishte kërkuar ETUCE-së mbështetje duke i shpjeguar se ajo kishte organizuar tre veprime sindikale të përshkallëzuara në fillim të vitit 2015, për shkak të moszbatimit të disa pjesëve të Kontratës Kolektive të nënshkruar me MASHT në prill 2014. Ndër detajet që ishin për t'u zbatuar nga janar 2015 ishin: 0.5 për qind e përvojës së punës për çdo vit shërbimi, një subvencion 70 për qind e biletës së autobusit për mësuesit udhëtar, dhe 2 euro në ditë pune për mësues për ushqim si dhe tri pagat me rastin e daljes në pension.

Edhe pas këtyre veprimeve të sindikatës, qeveria nuk e ka zbatuar ndonjë marrëveshje, edhe pse sindikata kishte dhënë Ministria e kohë të mjaftueshme dhe ka mbajtur shumë takime me përfaqësuesit e saj.

Suksesi do të vijë

Në letrën e saj, ETUCE tha se ajo qëndron "pa rezerva" me protestuesit dhe mbështet "kërkesat

e drejta dhe të justifikuar të tyre për një korrigjim të menjëhershëm të qasjes së pasaktë dhe të padrejtë të Ministrisë ". Ajo beson se përpjekjet dhe këmbëngulja e anëtarëve të SBASHK –ut për t'i kujtuar MASHT-it për përgjegjësinë e saj ndaj njerëzve që punojnë në arsim në fund do të çojë në sukses.

" ETUCE falënderon të gjithë protestuesit për kontributin e tyre të rëndësishëm të cilët e bëjnë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë përmes mbrojtjes së tyre aktive për cilësinë në arsim," tha Drejtori i ETUCE Martin Romer.

Afati kohor

Për të nxjerrë në pah shqetësimin e tyre të vazhdueshëm, Këshilli Drejtues i SBASHK-ut kishte vendosur të thërrasë një grevë të përgjithshme për 20 prill. Qeveria i kërkoj sindikatës mos të hyjnë në grevë, dhe gjatë një mbledhje të jashtëzakonshme me 18 Prill ajo vendosi se një nga kërkesat SBASHK –ut, ajo e 0.5 për qind e përvojës së punës - të zbatohet në pagën e prillit.

Më 19 prill, Këshilli Drejtues i SBASHK-ut vendosi të shtyjë grevën për një javë, për të parë nëse qeveria do të zbatojë vendimin e saj.

Megjithatë, Qeveria nuk e ka nderuar premtimin e saj. Në një mbledhje të jashtëzakonshme më 27 prill, Këshilli Drejtues i SBASHK-ut vendosi të thërrasë një grevë të përgjithshme në arsimin para-universitar dhe universitar nga data 29 prill.

Thirrje për dialog

Gjatë grevës, të gjithë të punësuarit duhet të jenë në vendet e tyre të punës, shpjegoi kryetari i SBASHK –ut Rahman Jasharaj, duke shtuar se "greva do të zgjasë për aq kohë sa Qeveria i korrigjon gabimet në listat e pagave". Megjithatë, obligimet e tjera qeveritare që dalin nga Kontrata Kolektive e nënshkruar në mes të SBASHK dhe

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



MASHT-i nuk duhet të harrohen, shtoi ai.

Për të mbrojtur arsimin cilësor dhe për të siguruar paqen sociale dhe drejtësinë në Kosovë, ETUCE shpreson për vazhdimin e një dialogu real dhe efektiv që çon "vetëm në pasojë të duhur e cila do të jetë zbatimi i duhur i Kontratës Kolektive të

nënshkruar nga të dy partnerët socialë, SBASHK dhe MASHT".

Më poshtë mund të lexoni artikullin original në gjuhën angleze:

http://www.ei-ie.org/en/news/news_details/3516



Education International
Internationale de l'Éducation
Internacional de la Educación

About Education International Resources & Research

English | French | Serbian

Home Education and Employment Rights and Equality Solidarity and Development Issues and Advocacy

News - Country: Kosovo - Theme: Others

Kosovo: union's collective bargaining efforts backed by European-wide support (04 May 2015)

The European region of Education International (EI) is demanding that Kosovo's public authorities fully implement the collective agreement that was signed a year ago.



Pristina National Library; image by Maco Fieber via Flickr

On 29 April, the European Trade Union Committee for Education (ETUCE) wrote to Education International (EI)'s affiliate, the Union of Education, Science and Culture of Kosovo (SBASHK), expressing its solidarity with the union for the protest action kicked off that morning in the pre-universities and universities.

The letter noted the "intolerable delaying tactics of the Ministry of Education Science and Technology of Kosovo (MEST)" in not respecting the agreement signed with the union representatives, acknowledging that their "patience has been truly put to the test".

Still waiting

The union had asked the ETUCE for support explaining that it had organised three escalating union actions at the beginning of 2015, because of the non-implementation of some parts of the collective agreement signed with the MEST in April 2014. Among the details that were to be implemented by January 2015 were: a 0.5 per cent salary increase according to work experience, a 70 per cent subsidy of bus ticket fee for commuting teachers, and 2 euros per working day per teacher for meals.

Even after these union actions, the Government did not implement any of the agreement, even though the trade union had given the Ministry enough time and held many meetings with its representatives.

Success will come

In its letter, the ETUCE said it stands "unreservedly" with the protesters and supports their "fair and justified demands for an immediate correction of the Ministry's inaccurate and unfair approach". It believes that SBASHK members' efforts and persistence in reminding the MEST of its responsibility towards people working in education will finally lead to success.

"The ETUCE thanks all the protesters for their important contribution which they make to build a better future through their active defence of the quality in education," ETUCE Director Martin Ramer said.

Timeline

To highlight its continuing concern, the SBASHK Executive Council had decided to call a general strike for 20 April. The Government asked the trade union not to strike, and during an extraordinary meeting 18 April it decided that one of the SBASHK requests – a 0.5 per cent salary increase according to work experience – would be implemented in the April salary of educators.

On 19 April, the SBASHK Executive Council decided to postpone the strike for one week, to check if the government was going to implement its decision.

However, the government did not honour its promise. At another extraordinary meeting on 27 April, the SBASHK Executive Council decided to call a general strike in pre-universities and universities as of 29 April.

Call for dialogue

During the strike, all employees must be in their work places, explained SBASHK President Rahman Jashari, adding that "the strike will last as long as the government does not correct errors in the payroll". However, other government obligations arising from the collective agreement signed between the SBASHK and the MEST must not be forgotten, he added.

To protect quality education and to ensure social peace and justice in Kosovo, the ETUCE hopes for a continuation of a real and effective dialogue leading to the "only correct consequence which will be the proper implementation of the collective agreement signed by the two social partners, SBASHK and MEST".

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosovo Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Bordi Kombëtar i AOB-së u njoftua me aktualitetin në SBASHK



Një delegacion i SBASHK-ut, i përbërë nga kryetari Rrahman Jasharaj, menaxheri financiar Ymer Ymeri dhe asistente Viora Rexhepi Berisha, qëndruan në Holandë për dy ditë, si mysafirë të sindikatës së Arsimit të Holandës - AOB.

Delegacionin e SBASHK-ut e priti kryetari i AOB-së z.Ulter Dresscher, sekretarja për marrëdhënie me ndërkombëtarë znj.Trudy Kerperien dhe kolegë tjerë sindikalistë.



Në fillimin e takimit të Bordit Kombëtar të AOB-së, ishte prezent edhe delegacioni ynë, ku kryetari Jasharaj pati një fjalim ku u diskutua për aktivitetet, sfidat dhe arritjet e SBASHK-ut.

Kryetari i SBASHK-ut duke dhënë hollësi për gjendjen aktuale, është kthyer në të kaluarën duke kujtuar se miku i madh i SBASHK-ut Dresscher ishte gjendur pranë mësimdhënësve të Kosovës edhe në vitet e vështira të okupimit.

SBASHK-u ka kujtuar edhe ditët e para të pasluftës kur z.Dresscher dhe AOB kishin gjetur organizata mbështetëse për të rinovuar dhe ndërtuar objekte shkollore dhe për të ndihmuar mësimdhënësit në ditët e para të pasluftës.

Në këtë fjalim rasti, SBASHK-u ka falënderuar sindikatën e Holandës duke u shprehur të bindur se bashkëpunimi dhe miqësia e sinqertë do të vazhdojë. Në këtë atmosferë, SBASHK-u para bordit kombëtar të AOB-së e ka shpallur z.Dresscher anëtar nderi të SBASHK-ut. Të pranishmit e kanë pritur mirë këtë gjest dhe z.Dresscher është shprehur se ndihet i nderuar dhe se do të vazhdojë të përkrahë SBASHK-un në angazhimet sindikale.

Po ashtu gjatë kësaj vizite, patëm rastin që të jemi prezent në një prej trajnimeve që sindikata e arsimit e Holandës organizon.

Takime të shumta me institucionet e Kosovës

SBASHK-u shembulli më i mirë i një sindikate të vërtetë



Nga muaji janar SBASHK-u u përball me sfidën për implementimin e Kontratës Kolektive . Sindikata jonë ishte shembulli më i mirë i dialogut . Nuk kishte ditë që SBASHK-u nuk insistonte për takime me qeveritarët. U zhvilluan dhjetëra takime me Ministrin e MASHT, z. Arsim Bajrami dhe anëtarë të Kabinetit të tij. U takua edhe me kryetarin e Komisionit për Arsim në Parlamentin e Kosovës . SBASHK-u kërkoi takime edhe me Ministrin Abrashi e Hoti. Gjithë këto takime nuk ishin të lehta sepse fjalët ecnin lehtë , por implementimi i marrëveshjes nuk shkonte si duhet. Kjo krijonte situatë të elektrizuar dhe në horizont qëndronte greva. SBASHK-u prapë preferonte dialogun dhe vetëm në rastet

kur nuk ecej fare tutje vinte në veprim veprimet sindikale. Kur afrohej greva qeveritarët bëheshin të disponuar për takime e dialog. Ministri Bajrami me kabinetin e tij edhe angazhoheshin për të realizuar pikat Kontratës, por nuk varehin gjithë çështjet nga ta. SBASHK-u zhvilloi takime edhe me zv/Ministrin e Financave ,z. Krasniqin, por një ditë më vonë edhe me Ministrin Hoti. Kishte edhe bashkëbiseda të tensionuara edhe deklarata të thëna nën presionin e në atmosferë hidhërimi momental, por në fund të fundit kështu e ka dialogu dhe vetë jeta. Pas gjithë atyre takimeve e përpjekjeve. Pas gjithë atyre veprimeve sindikale, që mahniten opinionin për unitetin e forcën e treguar, u nis diçka për së mbari. Po zbatohet për të gjithë të punësuarit në Arsimin Parauniversitar 0.5 % për çdo vit shërbimi në pagën bazë aktuale. Me dialogun e me takimet me qeveritarët do të vazhdojmë në shërbim të arsimit shqip dhe në përpjekje për të realizuar kërkesat legjitime të të punësuarve në arsimin e Kosovës.

Implemented by:

Disa nga aktivitetet sindikale në komuna

Sindikatat komunale gjatë këtij muaji

Në këtë numër të gazetës elektronike “Arsimimi Sot”, po paraqesim disa nga aktivitetet e dy komunave gjatë muajit prill 2015

Mitrovicë - z. Vjollca Shala (Kryetar i SAF & SAM në këtë komunë)

Në komunën e Mitrovicës janë zhvilluar aktivitete të shumta sindikale në këtë periudhë. Fillimisht është mbajtur Kuvendi Sindikal i Mitrovicës për zgjedhje të kryetarit të Sindikatës Komunale të AF dhe AM të Mitrovicës. Ku kryetare e Sindikatës Komunale të AF dhe AM të Mitrovicës u zgjedh Vjollca Shala profesore e TIK-ut në gjimnazin “Frang Bardhi”, ndërsa nënkryetar u zgjedh Isa Ismajli arsimtar i matematikës në shkollën e mesme të ulët “Migjeni”.

Shkolla e mesme e ulët “Fazli Grajqevci” ka mbajtur mbledhje për formim të Sindikatës së shkollës së tyre ku kam qenë edhe unë e ftuar. Është zgjedhur kryetarja e Sindikatës së kësaj shkolle Shpresa Bajrami. Shpresa ka mbetur të mbledh të dhënat për arsimtarët që do të antarësohen pasi një pjesë e madhe e tyre kanë shprehur dëshirën që të antarësohen në SBASHK.



Foto e Marreveshjes me “QTA” sh.p.k. Mitrovicë

Në takimet konsultative që kemi mbajtur me të gjithë kryetarët e shoqatave të Mitrovicës është arritur një qëndrim i përbashkët që përkrahim greven e përgjithshme me 20 prill deri në realizimin e të gjitha kërkesave të kontratës kolektive. Mirëpo pas sjelljes së një propozim –

vendimi nga ana e qeverisë për pages të shtesës së përvojës së punës 0.5% të pagës bazë, antarësia e Mitrovicës e ka mirëpritur këtë vendim dhe nuk i sheh si të arsyeshme veprimet e mëtutjeshme sindikale.

Kemi mbajtur takim me drejtoreshën komunale të arsimit në Mitrovicë z. Ajmane Barani. Me drejtoreshën e DKA në Mitrovicë i diskutuam shumë probleme me të cilat ballafaqohen mësimmshënësit e komunës tonë si: kontratën e përherëshme të punës, pagesa e 70% të rrugës për mësimmshënësit udhëtarë, tri pagat jubilarë për pensionistë, mësimmshënësit që nuk janë në listë të pagave, rritja e koeficientit për motrat edukatore, mos pagesa e kualifikimit të mësimmshënësve (si master apo kualifikim tjetër) dhe kërkuam një zyre për kryesinë e sindikatës komunale. Me një bashkpunim të ndërsjellë shpresojmë që në një të ardhme të afërt kërkesat tona do të realizohen.



Foto e Marreveshjes me barnatorën “Aspirin C” Mitrovicë

Në Komunën e Mitrovicës janë lidhur edhe dy marrëveshje për zbritje çmimesh. Barnatorja “Aspirin C” për antarësinë e SBASHK-ut bënë një zbritje prej 10% dhe Qendra Tregëtare Arjeta “QTA” sh.p.k 3% zbritje në ushqime dhe 5% zbritje në veshmbathje.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC



Gjakovë - z. Sali Maliqi (Kryetar i SAF & SAM në këtë komunë)

Në komunën e Gjakovës sindikalistët e arsimit parauniversitar kishin mirëpritur marrëveshjen e arritur mes Ministrisë së Arsimit, Ministrisë për Mirëqene Sociale, Ministrisë së Financave, si dhe SBASHK-ut . Kjo kishte bërë që greva e paralajmëruar për 20 të shtyhej për 24. Prill. SBASHK-u edhe një herë u dëshmuar se është për dialog dhe marrëveshje.

Mirëpo marrëveshjen nuk e realizoi Qeveria ashtu si kishte thënë dhe lëshoi lista pagash me plot gabime e duke mos u bazuar në pagën bazë aktuale.

Kjo bëri që Këshilli Drejtues në takimin e jashtëzakonshëm të shpallte grevë të përgjithshme.

Grevës edhe në komunën e Gjakovës i ishin përgjigjur të gjithë të punësuarit në arsim dhe kjo është një dëshmi e besimit ndaj SBASHK-ut. Besimi në SBASHK-un dhe uniteti i shkëlqyer kudo mes të punësuarve në arsimin Kosovës, pra edhe në Komunën e Gjakovës është vlerë që do të ruhet e kultivohet gjithmonë.

Implemented by:



Projekti i financuar nga BE
dhe menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë



Kosova Education Center
Qendra për Arsim e Kosovës

KEC

